

Data: 29.07.2025

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti i procedurës: “Blerje Gazkromatograf Bidimensional për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave”.

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (FPP)

38432000-2: Aparate analizues:

38432200-4: Kromatografë

Vlera e fondit limit i kontratës: 16,956,000 (gjashtëmbëdhjetë milion e nëntëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë) lekë **pa TVSH** ose **173,943.4** (njëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e dyzet e tre pikë katër) **Euro pa TVSH**.

Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë më datë 28.07.2025 është 97.48 lekë.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” (të ndryshuar) nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Autoriteti/Enti Kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara në rolin e Organit Qëndror Blerës, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas **Shtojcës 9**;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas **Shtojcës 4**;

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe në mbështetje të nenit 26, nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Neni 82, i LPP përcakton se “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”. Neni 83 i LPP përcakton se “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”,

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 25 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet**. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenin 43 pika 2/a të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Në pikën 1 të nenit 77 të LPP përcaktohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat

kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.” dhe në pikën 3 të tij përcaktohet se: “3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohej nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohej operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.”

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se vlera e fondit limit është në përputhje me përcaktimet në nenin 43 pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se: “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohej operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë :a) dyfishin e vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar”.

Në rastin konkret Njësia e Prokurimit ka konsideruar te arsyeshme që vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, nxitjen e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë si edhe të sigurimit të një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë ofertuesit e mundshëm ekonomikë. Marrë shkas nga fakti që referuar përcaktimit të bërë në nenin 43 pika 2/a, Autoriteti Kontraktor nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së përllogaritur të vlerës së fondit limit në kërkesën për kualifikim, por në respektim të parimeve ligjore dhe në përmbushjen e qëllimeve të ligjit të prokurimit si më sipër cituar ka tagrin të kërkojë një vlerë më të ulët se dyfishi i vlerës së përllogaritur të kontratës/lotit për përmbushjen e vlerës së xhiros minimale vjetore. Kjo vlerë është kërkuar duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, vlerën e fondit limit, me qëllim që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të viteve: (2022, 2023, 2024) të konfirmuara nga autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021

“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, te ndryshuar, si dhe në pikat 2 dhe 5 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “2 “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata” dhe në pikën 5 përcaktohet se: “.....Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitet sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji.”, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” të ndryshuar dhe nenit 14 të Nr. 10 091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” të ndryshuar.

Në pikën 1 të nenit 77 të LPP përcaktohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.” dhe në pikën 3 të tij përcaktohet se: “3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.”

Në nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 të ndryshuar përcaktohet se: “4. Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit⁴⁵. Nëse kërkohen bilance të tre viteve të fundit, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.”

Në nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” të ndryshuar, përcaktohet se: “Detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, individuale apo të konsoliduara, përpara publikimit të tyre: a) të gjitha njësitë ekonomike dhe grupet e njësive ekonomike me interes publik; b) të gjitha njësitë ekonomike dhe grupet e njësive ekonomike, të cilat në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vjet radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i. totali i aktiveve të bilancit në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse arrin ose e kalon shumë prej 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekësh; ii. shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumë prej 100 000 000 (njëqind milionë) lekësh; iii. ka mesatarisht të paktën 50 (pesëdhjetë) të punësuar gjatë periudhës kontabël.”

Me anë të këtij kriteri, për paraqitjen e bilnaceve të tre viteve të fundit financiare, është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, vlerën e fondit limit, më qëllim që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Dorëzimi i bilanceve kontabël të konfirmuar nga autoritet tatimore kërkohet për të dëshmuar se kopja e bilancit të paraqitur në këtë procedurë prokurimi është kopje e njëjtë me atë të paraqitur pranë administratës tatimore.

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, **në vlerën jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet.** Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:
 - a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
 - b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 1 dhe 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar nëni 40 pika 3 dhe 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

Në pikën 1 të nenit 77 të LPP përcaktohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.” dhe në pikën 4 të tij përcaktohet se: “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

Në nenin 40 pika 3 VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. përcaktohet se: “3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret

specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.” dhe në pikën 4 të tij përcaktohet se:

“ . Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. ”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e ngjashme cka duhet të vërtetohen nëpërmjet dokumenteve si më sipër kërkuar. Një operator ekonomik i cili ka realizuar më parë kontrata të ngjashme me objektin e prokurimit, i krijon bindjen dhe besueshmërinë te Autoritetit Kontraktor, se ai ka aftësi organizative, personelin e nevojshme dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie të kërkuar në dokumentet e tenderit.

Furnizimet e mëparshme të ngjashme janë kërkuar vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

2. Operatori ekonomik duhet të dorëzojë Autorizim/Marrëveshje me prodhuesin/distributorin e autorizuar nga prodhuesi për artikullin objekt prokurimi. Operatori ekonomik ofertues në rast paraqitje autorizimi/marrëveshje nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të provojë lidhjen ndërmjet prodhuesit dhe distributorit zyrtar të autorizuar nga prodhuesi. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: (telefon, fax, e-mail, website) të nevojshme për autoritetin kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 40 pika 8 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”

Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet për besueshmërinë, cilësinë dhe kapacitetet e operatorëve ekonomik ofertues. Autorizimi i prodhuesit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e mallit që kërkohet në procedurë, garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek Autoriteti Kontraktor të këtij malli, nisur edhe nga rëndësia dhe specifikat që ka malli objekt prokurimi. Në këtë kontekst, është domosdoshmërisht

në dobi të përfituesve finale për mallra sa më cilësore, pra garanci për zbatimin me rigorozitet të furnizimit të mallit. Në këtë mënyrë provohet dhe aftësia reale e operatorit ekonomik për të realizuar kontratën në cilësi, sasi e kohë. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesin cilësor të mallit që kërkohet të blihet e që është prodhuar në standardet apo prodhues të zyrtarizuar. Ky kriter është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e Operatorit Ekonomik ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së Operatorit Ekonomik për përmbushjen me sukses të kontratës. Kërkimi i autorizimit nga prodhuesi ose distributori i autorizuar për mallin është një masë e mirë për të mbrojtur interesat e institucionit dhe për të siguruar një prokurim të drejtë dhe transparent.

3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog/skedën teknike nga prodhuesi /ose distributori i autorizuar për mallin objekt prokurimi ku të tregohen dhe të markohen qartë karakteristikat e mallit që do të ofrohet, në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria e tyre me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara në dokumentat standarte të tenderit.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 40 pika 6/b të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. ku përcaktohet se: “6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: b) fotografitë apo katalogët teknikë;”.

Me anë të këtij kriteri, kërkohet që të verifikohet përputhshmëria e specifikimeve teknike, duke garantuar që produktet e ofruara i përmbushin të gjitha kërkesat teknike dhe funksionale të përcaktuara në specifikimet teknike në dokumentat e tenderit.

Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi, i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar mallrat e kërkuar, si dhe për të krahasuar pajtueshmërinë e specifikimeve teknike dhe standartet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor në dokumentet e tenderit, me specifikimet teknike të mallrave të ofruara nga operatori ekonomik. Nisur nga lloji i mallit që kërkohet, i cili është shumë i rëndësishme për punën e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, është e nevojshme që autoriteti kontraktor të sigurohet për mallrat që i ofrohen nga operatorët ekonomik pjesmarrës të vërtetuar nëpërmjet dokumenteve si katalog/ skedë të teknike ose broshura nga prodhuesi i këtyre mallrave.

4. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatë të lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar akreditues, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në përputhje me objektin e prokurimit, si më poshtë:

- ISO 9001 “Për menaxhimin e sistemit të cilësisë” ose ekuivalent (e vlefshme në datën e hapjes së procedurës);

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 77 dhe 79 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe në pikën 1 të nenit 44, të VKM-së Nr. 285 datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Në nenin 79 pika 1 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, përcaktohet se: *“1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.”*

Në nenin 44 pika 1 të të VKM-së Nr. 285 datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, përcaktohet se: *“1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.”.*

ISO 9001 “Për menaxhimin e sistemit të cilësisë” ose ekuivalent (e vlefshme) është standard ndërkombëtar që garanton se operatori ekonomik zbaton një sistem menaxhimi cilësie që përmirëson vazhdimisht proceset. Kërkesa për këtë certifikatë siguron që shërbimet ose produktet e kontratës do të përmbushin standarde të larta cilësie dhe do të kryhen me efikasitet.

5. Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë se pajisja e ofertuar është sipas normave të Konformitetit EC/Certifikatë CE ose ekuivalente e saj, si dhe të deklarojë se në momentin e dorëzimit, pajisja do të shoqërohet me Deklaratën e Konformitetit EC/ Certifikatë CE ose ekuivalente e saj, që vërteton të dhënat teknike, standartin e prodhimit sipas kërkesave mbi standartin e përcaktuar në specifikimet teknike).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 dhe 79 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar, neneve 8, 9,10,11 dhe 12 i ligjit nr. 10489 date 15.12.2011 “Për tregtimin dhe mbikqyrjen e tregut të produkteve jo ushqimore”, nenin 40 pika 8 dhe nenin 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, autoriteti kontraktor kërkon të sigurohet se, operatori ekonomik do të garantojë se malli i ofruar është cilësor dhe sipas standarteve të kërkuara në dokumentet e tenderit.

Deklarata nga operatori ekonomik se pajisja e ofertuar është sipas normave të Konformitetit EC/Certifikatat CE ose ekuivalente e saj dhe në momentin e dorëzimit të pajisjes në Autoritetin Kontraktor përfitues pajisja të shoqërohet me Deklaratën e Konformitetit EC / Certifikatat CE ose ekuivalente e saj, kërkohet për të demonstruar përmbushjen e kërkesave për të gjitha aktet ligjore apo nënligjore të zbatueshme ndaj produktit, përfshirë dhe procedurën e vlerësimit të konformitetit, sipas moduleve përkatëse.

6. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për instalimin, kalibrimin, vënien në punë të pajisjes dhe trajnimin e stafit të Autoritetit Kontraktor përfitues, sipas përcaktimeve të bëra në shtojcën 6 “formulari i specifikimeve teknike”, duhet të disponojë minimalisht 1 (një) specialist të pajisur me çertifikate trajnimi të lëshuar nga prodhuesi ose distributori i autorizuar ose autoritete / ente të tjera, të autorizuar për lëshimin e certifikatave të formimit profesional/ose ekuivalent, në përputhje me natyrën e pajisjes si më sipër.

Për specialistin e kërkuar duhet të paraqesë dokumentet:

- Kontratë pune/kontratë bashkëpunimi, të vlefshme.
- Certifikatë trajnimi e lëshuar nga prodhuesi ose distributori i autorizuar, ose autoritete /ente të tjera, të autorizuar për lëshimin e certifikatave të formimit profesional/ose ekuivalent, në përputhje me natyrën e pajisjeve.

Shënim: Kriteri konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar dhe nenin 40 pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri autoriteti kontraktor kërkon të sigurohet se operatori ekonomik ka në dispozicion staf të kualifikuar për realizimin e objektit të prokurimit. Duke qënë se malli objekt prokurimi është pajisje laboratorike specifike, Aparat për analizën e Euromarker-it Butoxybenzeniy (ACCUTRACE™) Plus, BPE-së (Eter Butil Fenil) në naftën për anijet e peshkimit, është e nevojshme që operatori ekonomik të ketë në dispozicion një specialist të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës sipas objektit të prokurimit. Specialisti i kërkuar është i nevojshëm për instalimin, kalibrimin, vënien në punë të pajisjes dhe trajnimin e stafit të Autoritetit Kontraktor përfitues brenda parametrave optimalë për të funksionuar pajisja e kërkuar, me qëllim përmbushjen e të gjitha funksionaliteteve të saj. Specialisti në dispozicion të operatorit ekonomik mund të jetë i certifikuar nga prodhuesi ose nga autoritete të autorizuar/ certifikuar për lëshuar certifikata/dëshmi trajnimi/kualifikimi për pajisjen objekt prokurimi ose ekuivalente, kjo me qëllim zgjerimin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomik. Kërkesa që specialisti i certifikuar/kualifikuar i operatorit ekonomik, të bëjë instalimin, kalibrimin, vënien në punë të pajisjes dhe trajnimin e stafit të AK përfitues është vendosur për të siguruar që përdoruesit të dinë se si të përdorin pajisjen në mënyrë të sigurt duke minimizuar rrezikun e aksidenteve apo dëmtimeve lidhur me këtë pajisje. Përdoruesit e trajnuar do të jenë më të aftë të përdorin pajisjen në mënyrë efikase duke përmirësuar produktivitetin dhe cilësinë e rezultateve të matjeve. Gjithashtu njohuritë e duhura për përdorimin dhe mirëmbajtjen e pajisjes ndihmojnë në jetëgjatësinë e kësaj pajisje.

Dokumentacioni i kërkuar për punonjësën është i nevojshëm për të provuar që është i pajisur me certifikate/çdo dokument tjetër që të vërtetojë trajnimin/kualifikimin për pajisje gaz- kromatograf dy-dimensional me detektor me selektim mase dhe detektor të jonizimit me flakë (sistem GC-MSD-FID) për analizën e Euromarker-it Butoxybenzeniy (ACCUTRACE™) Plus, BPE-së (Eter Butil Fenil) në naftën për anijet e peshkimit, ose ekuivalente.

7. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës të deklarojë se garancia e pajisjes laboratorike do të jetë sipas përcaktimeve të shtojcës 6 “*formulari i specifikimeve teknike*” dhe se pajisja laboratorike në momentin e dorëzimit do të shoqërohet me fletë garancie.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar dhe nenin 40 pika 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri, autoriteti kontraktor kërkon të sigurohet se, operatori ekonomik do të garantojë se malli i ofruar është cilësor dhe sipas standarteve të kërkuara në dokumentet e tenderit. Në cdo rast operatori ekonomik gjatë periudhës së garancisë duhet të mbajë përgjegjësi për mallin që ofron dhe se do t’i përgjigjet autoritetit kontraktor në rast se malli i furnizuar dëmtohet gjatë përdorimit për shkak të defekteve që vijnë si rrjedhojë e prodhimit apo instalimit/kalibrimin të tij.

8. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të cilës merr përsipër instalimin, vënien në pune, kalibrimin, testimin si edhe trajnimin e stafit të Autoriteti Kontraktor përfitues sipas afateve dhe përcaktimeve të bëra në shtojcën 6 “*formulari i specifikimeve teknike*” pjesë përbërëse e dokumentave standarte të tenderit.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët të sigurojnë Autoritetin Kontraktor se instalimi, vënia në pune, kalibrimi, testimi si edhe trajnimi i stafit të Autoriteti Kontraktor përfitues do të realizohet në kohë dhe në vendin e caktuar nga Autoriteti Kontraktor përfitues brenda parametrave optimalë për të funksionuar siç duhet, në përmbushjen e funksionalitetit të tij dhe përmbushjes korrekt të qëllimit për të cilin kërkohet kjo pajisje dhe për këtë operatori ekonomik do të lëshojë certifikatë kalibrimi të pajisjes, duke siguruar Autoritetin Kontraktor se pajisja është në funksion të plotë dhe sipas rregullave. Referuar edhe përcaktimeve të bëra në specifikimet teknike është cilësuar edhe kërkesa për kryerjen e trajnimit për përdoruesit e kësaj pajisje, pjesë e stafit të Autoritetit kontraktor përfitues. Qëllimi i vendosjes së deklaratës përpos të tjerave edhe i kërkesës për trajnimin është vendosur për të siguruar që përdoruesit të dinë se si të përdorin pajisjen në mënyrë të sigurt duke minimizuar rrezikun e aksidenteve apo dëmtimeve lidhur me këtë pajisje. Përdoruesit e trajnuar do të jenë më të aftë të përdorin pajisjen në mënyrë efikase duke përmirësuar produktivitetin dhe cilësinë e rezultateve të matjeve. Gjithashtu njohuritë e duhura për përdorimin dhe mirëmbajtjen e pajisjes ndihmojnë në jetëgjatësinë e kësaj pajisje.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

Specifikimet teknike sipas DST janë hartuar nga grupi i punës i ngritur nga Titullari i Autoritetit Kontraktor përfitues Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, në përputhje me ligjin nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i specifikimeve teknike iu është referuar Vendimit për zbatim të komisionit European Nr. 2022/197, datë 17.01.2022 “Mbi vendosjen e një markuesi të përbashkët fiskal (Euromarker-ACCUTRACE™ Plus) për gazoil, gasolinë, vajguri etj.,” i cili do të përcaktohet më metodën ILIADe 606:2023. Vendosja e këtyre specifikimeve garanton AK përfitues si blerës të një produkti mjaft cilësor, që mbulon analizimin e kësaj game produktesh, konform kërkesave bashkëkohore, si dhe garanton cilësinë e lartë të analizimit sasior të këtij markuesi për gazoilin që përdoret në anijet e peshkimit, etj.,

Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti.

Specifikimet Teknike

Pajisja është gaz- kromatograf dy-dimensional me detektor me selektim mase dhe detektor të jonizimit me flakë (sistem GC-MSD-FID) për analizën e Euromarker-it Butoxybenzeniy (ACCUTRACE™) Plus, BPE-së (Eter Butil Fenil) në naftën për anijet e peshkimit.

Emërtimi

Gaz kromatograf dy-dimensional

Gaz kromatograf dy-dimensional (në vijim GC) me detektor me selektim mase dhe detektor për jonizimin me flakë (në sistemin GC-MSD-FID) me UPS, për analizën e naftës.

1: Kërkesat teknike

GC-ja duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

Titulli i kërkesës

2.1 Hyrja e GC-së

Temperatura e injektorit të jetë e programueshme. Kërkohet SSL (Split/Splitless).

2.2 Hyrja e GC-së

Temperatura maksimale të jetë jo më pak se 400°C.

2.3 Hyrja e GC-së

Me mundësi që të lidhet (instalohet) kolona kapilare me diametër të brendshëm nga 50 µm deri në 500 µm.

2.4 Hyrja e GC-së

Të jetë i mundur ndërrimi i liner-it me shpejtësi.

2.5 Hyrja e GC-së

Të jetë i mundur injektimi me ndarje (split) dhe i kombinuar ndarje/pa ndarje (split/splitless).

2.6 Sistemi i hyrjes

Sistemi të ketë funksion rikthimi (backflush) për shpëlarjen e matricës, i cili mund të kontrollohet automatikisht nga softueri.

Emërtimi

2.7 Kontrolli i presionit dhe fluksit

Kontrolli elektronik i presionit dhe fluksit (rrjedhës) të përmbushë kushtet minimale të mëposhtme:

- a) 0 deri në 500 kPa (0.001 psi deri në afërsisht 100 psi),
- b) Fluksi (rrjedha) në kolonë: nga 0 mL/min deri në 30 mL/min,
- c) Raporti i ndarjes (split ratio): 1000:1

2.8 Furra e GC-së

Puna do të jetë e mundur në temperatura nga maksimumi 5°C mbi temperaturën e dhomës deri në 450°C.

2.9 Furra e GC-së

Shkalla e ngrohjes, minimalisht në gjithë intervalin nga 0 deri në 120 °C/min.

2.10 Furra e GC-së

Shkallë e shpejtë ftohjeje nga 400 °C në 50 °C për më pak se 5 minuta.

2.11 Kontrolli i furrës së GC-së

Të paktën 5 nivele izotermike të programueshme dhe të paktën 10 programe temperature.

2.12 Autosampler i GC-së

Njësi për futjen e mostrës për injektim të lëngshëm, duke përfshirë të gjitha pjesët lidhëse të nevojshme, kabllot e lidhjes dhe përshtatësit për sistemet e hyrjes.

2.13 Autosampler i GC-së

Duhet të përfshihen komponentët e mëposhtëm:

- a) Stacion larës me të paktën 3 viale,
- b) Pjatë mostre për të paktën 100 viale (nga 2 ml secila).

2.14 GC autosampler

Very good reproducibility (less than 0.3% RSD) in relation to peak area.

2.15 GC autosampler

Very good reproducibility, or injection time (less than 0.008 minutes) during injection.

2.16 Autosampler i GC-së

Vëllimi i injektimit të jetë i ndryshueshëm nga 0.1 deri në 10 µl.

2.17 Autosampler i GC-së

Autosampler me vetërregullim.

2.18 Autosampler i GC-së

Njësia duhet të ketë mbajtës universal për shiringa prej 5, 10, 50 dhe 100 µl.

2.19 Autosampler i GC-së

Të jetë e mundur përdorimi i vialëve me kapak me shtypje (crimp) dhe me fileto (screw cap).

2.20 Autosampler i GC-së

Pjata e mostrave do të jetë e vendosur në mënyrë të tillë që të mos ketë ndikim termik mbi mostrat nga furra

Emërtimi
e kolonës.
2.21 Linja e transferimit GC-MSD
Të jetë ndërfaqe (interface) me temperaturë të lartë, me temperaturë deri në 350 °C.
2.22 Lidhjet e GC-së
Të gjitha lidhëset të jenë Swagelok (ose ekuivalente) prej 1/4 inç dhe tubat prej bakri 1/8 inç, të nevojshme për lidhjen e GC me bombolat e gazeve, të përfshihen në set-in e aparaturës.
2.23 Transferuesi (ndryshuesi) GC-DEANS
Njësia duhet të ketë një të ashtuquajtur transferimi (ndryshimi) DEANS, i cili lejon drejtimin e rrjedhës së eluentit drejt një kolone të dytë dhe një detektor të dytë në mënyrë të kontrolluar në kohë.
2.24 Kolonat GC
Kolona kapilare dhe kufizues (restrictor) i kapilaritetit.
Kolona 1: "DB-1HT", ose ekuivalente, 15 m e gjatë, me diametër të brendshëm 0.25 mm, trashësi shtrese 0.1 µm, ose një kolonë tjetër me diphenyl/dimethylpolysiloxane me përmasat e përcaktuara, polaritet të krahasueshëm dhe temperaturë maksimale të paktën 400 °C.
Kolona 2: "SLB®-IL60", ose ekuivalente, 30 m e gjatë, me diametër të brendshëm 0.25 mm, trashësi shtrese 0.2 µm, ose një kolonë tjetër me përmasat e përcaktuara, polaritet të krahasueshëm dhe temperaturë maksimale të paktën 300 °C. (Përdorimi i njëkohshëm i të dy kolonave në temperatura më të larta se 300 °C nuk është i parashikuar.)
Kolona 3: Kufizues (restrictor) kapilariteti për FID: 0.68 m x 0.1 mm, silicë e shkrirë (fused silica), ose ekuivalente.
2.25 Kursyesi i gazit për GC (GC Gassaver)
Konsumi i reduktuar i gazit mbartës përmes një funksioni kursimi gazi që duhet të jetë i programueshëm.
Mënyra e realizimit, variabël(mund të jetë e ndryshme).
2.26 Kontrolli i rrjedhjeve në GC
Duhet të ketë një pajisje të brendshme për kontrollin e rrjedhjeve (minimalisht sensor).
2.27 GC
Funksionet e kontrollit dhe mirëmbajtjes së GC-së duhet të jenë të aksesueshme drejtpërdrejt përmes një ekrani me prekje (touchscreen), por të mund të kontrollohet edhe nga software.
Titulli i kërkesës
3.1 Detektori 1 – Detektor me Jonizim në Flakë (FID)
Shpejtësia e regjistrimit të të dhënave duhet të jetë të paktën 500 Hz.
3.2 Detektori 1 – Detektor me Jonizim në Flakë (FID)
FID duhet të ketë një gamë lineare dinamike të gjerë, më të madhe se 10 ⁷ .
3.3 Detektori 1 – Detektor me Jonizim në Flakë (FID)
Duhet të ketë ndezje dhe rindezje automatike në rast fikjeje të flakës.
3.4 Detektori 1 – Detektor me Jonizim në Flakë (FID)
Të jetë e mundur lidhja e kolonave kapilare me diametër të brendshëm nga 50 µm deri në 500 µm. (pika 2.3)
3.5 Detektori 1 – Detektor me Jonizim në Flakë (FID)
Temperatura duhet të jetë e mundur të arrijë të paktën 350 °C.
Titulli i kërkesës

Emërtimi
4.1 Detektori 2 – Detektor me selektim mase (MSD) Duhet të jetë spektrometër mase me një katërpolësh (quadrupole) të vetëm.
4.2 Detektori 2 – Detektor me selektim mase (MSD) MSD duhet të ketë dy burime inerte të jonizimit me ndikim të elektroneve (EI) me filament të dyfishtë dhe mund të nxehet deri në 350 °C.
4.3 Detektori 2 – Detektor me selektim mase (MSD) Duhet të përmbushë kriteret e mëposhtme: a) Të jetë i mundur regjistrimi i njëkohshëm i të dhënave në mënyrat FullScan dhe SIM. b) Gama e masës nga 15 deri të paktën 1000 amu. c) Shpejtësia e skanimit të jetë të paktën 15,000 amu/sek.
4.4 Detektori 2 – Detektor me selektim mase (MSD) Duhet të përfshijë një pompë turbomolekulare me kapacitet prej të paktën 200 l/sek.
4.5 Detektori 2 – Detektor me selektim mase (MSD) Sistemi duhet të përdorë një pompë mbështetëse vakumi pa vaj.
Titulli i kërkesës
5.1 PC Duhet të ketë një PC kontrolli të jashtëm të përfshirë në set-in e dorëzimit të aparaturës.
5.2 Pajisjet e kompjuterit (PC) Hardueri i kompjuterit (CPU, RAM, kartë grafike, HDD) duhet të jetë i përditësuar (p.sh. të paktën Intel® Core i7 me 4 bërthama – 16 GB RAM – 500 GB HDD, DVD-shkrues, kartë grafike me dy dalje HDMI/DVI/DisplayPort dhe me kujtesë grafike të mjaftueshme, porta USB, dy porta LAN) dhe të mundësojë funksionimin e besueshëm dhe të pandërprerë të softuerit për të kontrolluar analizat.
5.3 Aksesorët e kompjuterit: Përmbajtja e dorëzimit duhet të përfshijë një maus, tastierë, media instalimi (MS Office, sistem operativ, softueri i pajisjes, CD me drejtues - drivers).
5.4 Aksesorët e kompjuterit Përmbajtja e dorëzimit duhet të përfshijë një printer lazer ngjyra, me funksion duplex dhe me lidhje në rrjet.
5.5 Aksesorët e kompjuterit Përmbajtja në dorëzim të aparaturës duhet të përfshijë: Të paktën një monitor me madhësi ekrani prej të paktën 24 inç.
Titulli i kërkesës
6.1 Sistemi Operativ Sistemi operativ duhet të jetë Windows 10 ose version më i ri dhe të jetë i pajisur me përditësime sigurie për të paktën 3 vjet nga data e marrjes në dorëzim të aparaturës.
6.2 Softueri Office Paketa Microsoft Office (Office 2019 ose më i ri, versioni standard), duhet të jetë e pajisur me përditësime sigurie për të paktën 3 vjet nga data e marrjes në dorëzim të aparaturës dhe nuk duhet të jetë pjesë e një abonimi Office 365.
Titulli i kërkesës
7.1 Softueri i kontrollit, diagnostikimit dhe vlerësimit Duhet të mundësojë krijimin dhe vlerësimin automatik të kromatogramit.

Emërtimi
7.2 Softueri i kontrollit, diagnostikimit dhe vlerësimit Softueri duhet të mundësojë krijimin e raporteve të konfiguruar sipas nevojës.
7.3 Softueri i kontrollit, diagnostikimit dhe vlerësimit Duhet të jetë e mundur përpunimi shtesë grafik dhe manual (si identifikimi dhe integrimi i pikut).
7.4 Softueri i kontrollit, diagnostikimit dhe vlerësimit Softueri duhet të lejojë kalibrimin me standard të brendshëm dhe me injektive të shumëfishta.
7.5 Softueri i kontrollit, diagnostikimit dhe vlerësimit Duhet të jetë e mundur kërkimi automatik i spektrit dhe redaktimi i librarisë.
7.6 Softueri i kontrollit, diagnostikimit dhe vlerësimit Duhet të jetë e mundur përcaktimi sasior i analizuesve si dhe krahasimi i kromatogramëve ose spektrave.
7.7 Softueri i kontrollit, diagnostikimit dhe vlerësimit Duhet të përfshijë një bazë të dhënash të përditësuar NISTose ekuivalente, për spektrometrinë e masës (MS).
7.8 Softueri i kontrollit, diagnostikimit dhe vlerësimit Raportet / raportet përmbledhëse duhet të mund të krijohen edhe në formate ASCII dhe PDF për eksportim në një sistem LIMS (shih gjithashtu pika 7.9).
7.9 Softueri i kontrollit, diagnostikimit dhe vlerësimit Një shembull i një skedari të tillë eksporti (shih pikën 8.5) duhet të paraqitet së bashku me ofertën.
7.10 Softueri i kontrollit, diagnostikimit dhe vlerësimit Softueri duhet të mundësojë kryerjen automatike të procesit të shpëlarjes së pasme të matricës (matrix backflushing).
Titulli i kërkeses
8.1 Dorëzimi / Instalimi Sistemi i plotë duhet të dorëzohet duke përfshirë instalimin gati për përdorim dhe vendosjen “falas deri në pikën e përdorimit” (furnizim me energji elektrike 220V/230 V).
8.2 Dorëzimi / Instalimi Pas instalimit, të paktën një portë USB dhe një portë rrjeti duhet të mbeten të lira në kompjuter.
8.3 Dorëzimi / Instalimi Duhet të përfshihen mjetet për rikuperimin e softuerit.
8.4 Licencat Licencat e softuerit duhet të jenë të vlefshme për një periudhë të pakufizuar kohore.
8.5 Funksionimi i softuerit (Qasja në internet) Funksionimi i sistemit dhe i kompjuterit, në veçanti instalimi i softuerit, duhet të jetë i mundur edhe pa një lidhje të përhershme me internetin.
8.6 Afati i dorëzimit Afati i dorëzimit pas vendosjes së porosisë është brenda 90 ditëve nga nënshkrimi i kontratës.
8.7 Dorëzimi i sistemit Sistemi duhet të dorëzohet pas një testimi të kualifikuar të sistemit, i shoqëruar me raport.
8.8 Pajisjet bazë të sistemit Sistemi duhet të furnizohet me materiale të konsumueshme bazë (septa, të paktën 5 linera injektor – ultra-inert me lesh qelqi, unaza mbyllëse (ferrules), të paktën 5 shiringa, dhe të paktën 2 fije (filamente)) dhe 400 vialë 2ml.
8.9 Udhëzim pas instalimit dhe trajnim bazë për pajisjen

Emërtimi
Çmimi i ofertës duhet të përfshijë të paktën 5 ditë pune trajnim, për mënyrën e funksionimit të aparaturës (trajnim bazë) për të paktën 4 punonjës dhe implementimin e të paktën një metode, BPE-së (Eter Butil Fenil) në naftë, sipas specifikimeve, e shoqëruar me raport. Aparatura duhet të kalibrohet/validim/OQ nga specialist i autorizuar dhe i licensuar për kalibrim/validim/OQ (shoqëruar me Certifikatat përkatëse personale dhe për aparaturën). Gjithashtu, standartet (CRM) që do të përdoren, duhet të jenë të përfshira në ofertë.
8.10 Manualët / udhëzimet e përdorimit Dorëzimi duhet të përfshijë manualët/udhëzimet e përdorimit, të jenë në gjuhën angleze, për të gjitha komponentët dhe softuerin. Manuali bazë i përdorimit (operacionale) të jetë në gjuhën shqipe. Në manual, të markohet në mënyrë të qartë dhe të dallueshme secila nga pajisjet që oferton sipas modelit të deklaruar si dhe të markohen specifikimet përkatëse sipas të dhënave në DST.
8.11 Riparimi Çmimi i ofertës duhet të përfshijë riparimet falas për defektet për një periudhë prej një viti, nga data e pranimit të aparatit.
8.12 Mirëmbajtja Çmimi i ofertës përfshin Mirëmbajtje + Kalibrim/Validation/OQ (pas riparimit të difektit) falas deri 12 muaj pas dorëzimit të aparaturës.
8.13 Pjesët këmbimi / aksesorët / materialet e konsumueshme Pjesët këmbimi, aksesorët, materialet e konsumueshme dhe mbështetja teknike duhet të jenë të disponueshme për një periudhë prej të paktën 2 vitesh.
8.14 Shërbimi në vend Në rast nevojë (defekte, dëmtime apo probleme funksionale), një teknik i shërbimit duhet të jetë i pranishëm në vend, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pune nga njoftimi i përdoruesit.
8.15 Dokumentacioni që duhet të dorëzohet Broshurat, fletët e të dhënave dhe përshkrimet teknike duhet të përfshihen në ofertë, preferohet në gjuhën angleze. Manuali bazë (operacional) i përdorimit të jetë në gjuhën shqipe.
8.16 Moduli UPS: Moduli UPS duhet të përfshihet për të siguruar furnizimin me energji elektrike për pompën ndihmëse për një kohë prej të paktën dy (2) minutash (kohëzgjatja deri sa të aktivizohet gjeneratori ekzistues i emergjencës).
8.17 Moduli UPS: UPS me bypass të brendshëm automatik.
8.18 Moduli UPS: UPS me dalje prej të paktën 3 kW.
8.19 Moduli UPS: UPS-i duhet të vihet në punë duke përdorur një nga prizat ekzistuese 220V/230 V, pa pasur nevojë për instalim të veçantë nga një specialist i fushës.

Shënim: Për çdo certifikatë, standart, markë, emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës të përmendur më lart, pranohet edhe ekuivalenti i tyre.

NJËSIA E PROKURIMIT